



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA FIER

Nr. _____ Prot.

Fier, më .09.2026

Lënda: Formulari i njoftimit të fituesit, pas publikimit të të cilit fillojnë afatet e ankimimit për procedurën me objekt **“Blerje automjet zjarrfikës (Pickup) për Drejtorinë e MZSH-së”**, me burim financimi nga Buxheti i Bashkisë Fier.

AGJENCISË SË PROKURIMIT PUBLIK
TIRANË
(për botim)

Shtojca 11.

FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT, PAS PUBLIKIMIT TË TË CILIT FILLOJNË
AFATET E ANKIMIT

Data 10.09.2026

Drejtuar:

Operatorit Ekonomik (OE) ☐ ose

Nova Motor Solutions SHPK, me numër NUIS M51901012F, adresa: Tirane Tirane Vaqarr,
Magazine 1 kateshe, mbas kështjellës, Konti, Zona Kadastrale 3712, Numer pasurie 18/54.

Bashkimit të Operatorëve Ekonomikë (BOE) ☐

[Emrat, Nipt-et, % përkatëse dhe adresat e anëtarëve të BOE]

- OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO X

Nëse po, të jepen dhënat _____

(Emrat e nënkontraktorëve, Nipt-et, % e nënkontraktimit)

-OE/BOE me Subjekt Mbështetës:

PO ☐ JO X

Nëse po, të jepen dhënat: _____

[Emrat, Nipt-et, përkatëse dhe adresat]

Tipi i Kontratës: Mall

Lloji i Procedurës së prokurimit: “Procedurë e hapur e thjeshtuar me mjete elektronike”

Numri i Procedurës / referenca e Lotit: REF-96617-08-18-2026

Përshkrimi i shkurtër i kontratës: “Blerje automjet zjarrfikës (Pickup) për Drejtorinë e MZSH-së”, me fond limit **5 083 333** (*pesë milion e tetëdhjetë e tre mijë e treqind e tridhjetë e tre*) **lekë pa TVSH dhe 6 099 999.6** (*gjashtë milion e nëntëdhjetë e nëntë mijë e nëntëqind e nëntëdhjetë e nëntë pikë gjashtë*) **lekë me TVSH**, vënë në dispozicion nga buxheti i Bashkisë Fier. Afati për zbatimin e saj: Jo më vonë se 60 (gjashtëdhjetë) ditë kalendarike nga nënshkrimi i kontratës.

Data e Publikimit të Njoftimit të Kontratës në SPE: 19.08.2026.

Data e Publikimit të Njoftimit të Kontratës në Buletinin e Njoftimeve Publike [24.08.2026] [Nr.54]

KRITERET E PËRZGJEDHJES SË FITUESIT:

- oferta ekonomike më e favorshme bazuar në kosto ☐
- oferta ekonomike më e favorshme bazuar në çmim X

Me anë të këtij Formulari ju informojmë se, në këtë procedurë/lot kanë marrë pjesë, Ofertuesit e mëposhtëm me këto vlera përkatëse të ofruara:

1. Operatori ekonomik Nova Motor Solutions SHPK, me numër NUIS M51901012F. Vlera totale sipas formularit të ofertës është 4 829 000 (katër milion e tetëqind e njëzet e nëntë mijë) lekë pa TVSH.
2. Operatori ekonomik ARTEO 2018 SHPK me NUIS L82523203F. Vlera totale sipas formularit të ofertës është 4 970 000 (*katër milion e nëntëqind e shtatëdhjetë mijë*) lekë pa TVSH.

Nga pjesëmarrësit janë skualifikuar, Ofertuesit e mëposhtëm:

Operatori ekonomik ARTEO 2018 SHPK me NUIS L82523203F

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave pasi shqyrtoi dhe verifikoi dokumentacionin ligjor, ekonomik dhe teknik, të paraqitur në SPE nga operatori ekonomik pjesëmarrës "ARTEO 2018"shpk, me NUIS L82523203F, konstatoi mangësit si më poshtë:

- Referuar Shtojcës 8, “Kriteret e veçanta të kualifikimit”, “Kapaciteti ekonomik dhe financiar:”, në pikën 2.2.1, ku përcaktohet se:

“Kopje të deklaratave të xhiros vjetore, të realizuar nga operatori ekonomik ofertues gjatë 2 (dy) viteve të fundit (2024, 2025) lëshuar nga Administrata Tatimore, me vlerë jo më pak se 2 000 000 lekë pa TVSH (e cila është një vlerë jo më e madhe se 40 % të vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet). Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti kontraktor. Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë ky kriter plotësohet nga secili anëtar i bashkimit në raport me përqindjen dhe/ose kushtet e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.”

Nga verifikimi i komisionit të vlerësimit të ofertave rezulton qe operatori ekonomik ARTEO 2018 SH.P.K nuk ka ngarkuar në sistem kopje të deklaratave të xhiros vjetore, të realizuar gjatë 2 (dy)

viteve të fundit (2024, 2025) lëshuar nga Administrata Tatimore, me vlerë jo më pak se 2 000 000 lekë pa TVSH .

- Referuar Shtojcës 8, “Kriteret e veçanta të kualifikimit”, “Kapaciteti teknik”, në pikën 2.3.1, ku përcaktohet se:

“ Për të provuar përvojën e mëparshme, kërkohen dëshmi për furnizimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit. Në këtë rast vlera e kërkuar është jo më pak se 1 000 000 lekë pa TVSH (e cila është një vlerë jo më e madhe se 20% të vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet), që është realizuar gjatë tri viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.”

Në përmbushje të këtij kriteri operatori ekonomik nuk ka ngarkuar në sistem dëshmi për furnizimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit me vlerë jo më pak se 1 000 000 lekë pa TVSH (e cila është një vlerë jo më e madhe se 20% të vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet), që është realizuar gjatë tri viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.”

- Referuar Shtojcës 8, “Kriteret e veçanta të kualifikimit”, “Kapaciteti teknik”, në pikën 2.3.2, ku përcaktohet se:

“ Për shasinë / automjetin bazë, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë Autorizim Prodhuesi ose Autorizim nga Distributori i autorizuar nga Prodhuesi, për automjetin (shasinë) e ofruar. Në rast se do të paraqitet Autorizim nga Distributori i autorizuar nga Prodhuesi, duhet të provohet edhe lidhja midis Prodhuesit dhe Distributorit të autorizuar. Secili nga dokumentat duhet të jetë i vlefshëm, si dhe të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit ose distributorit të autorizuar si: tel, fax, email, website, etj., kjo e nevojshme për AK në rast verifikimi nga ana e tij. Në rastin kur Autorizimi i Prodhuesit ose Autorizimi nga Distributori i autorizuar nga Prodhuesi është në gjuhë të huaj duhet të jetë i përkthyer në gjuhën shqipe dhe i noterizuar. “

Në përmbushje të këtij kriteri nga verifikimi i komisionit të ofertave , operatori ekonomik nuk ka ngarkuar në sistem Autorizim Prodhuesi ose Autorizim nga Distributori i autorizuar nga Prodhuesi për shasinë / automjetin bazë .

- Referuar Shtojcës 8, “Kriteret e veçanta të kualifikimit”, “Kapaciteti teknik”, në pikën 2.3.3, ku përcaktohet se:

“Për superstrukturën / agregatin zjarrfikës operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë Autorizim Prodhuesi ose Autorizim nga Distributori i autorizuar nga Prodhuesi për superstrukturën zjarrfikëse dhe agregatin zjarrfikës të ofruar. Në rast se do të paraqitet Autorizim nga Distributori i autorizuar nga Prodhuesi, duhet të provohet edhe lidhja midis Prodhuesit dhe Distributorit të autorizuar. Secili nga dokumentat duhet të jetë i vlefshëm, si dhe të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit ose distributorit të autorizuar si: tel, fax, email, website, etj., kjo e nevojshme për AK në rast verifikimi nga ana e tij. Në rastin kur Autorizimi i Prodhuesit ose Autorizimi nga Distributori i autorizuar nga Prodhuesi është në gjuhë të huaj duhet të jetë i përkthyer në gjuhën shqipe dhe i noterizuar.”

Në përmbushje të këtij kriteri nga verifikimi i komisionit të ofertave , operatori ekonomik nuk ka ngarkuar në sistem Autorizim Prodhuesi ose Autorizim nga Distributori i autorizuar nga Prodhuesi për superstrukturën / agregatin zjarrfikës.

- Referuar Shtojcës 8, “Kriteret e veçanta të kualifikimit ”, “Kapaciteti teknik”, në pikën 2.3.4, ku përcaktohet se:

“Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë katalog/katalogje të prodhuesit ose fragmente të katalogut/eve të prodhuesit ose skedë teknike të prodhuesit, ku të jetë specifikuar produkti që është paraqitur në ofertë dhe specifikimet teknike, për të gjetur pasqyrim parametrat teknikë të automjetit të ofruar (shasisë dhe agregatit zjarrfikës) (shih specifikimet teknike) të kërkuara nga autoriteti kontraktor dhe të ofruara nga operatori ekonomik. Ne rastin kur katalogu/katalogjet e prodhuesit ose fragmentet e katalogut/eve të prodhuesit ose skeda teknike e prodhuesit është në gjuhë të huaj duhet të jetë i përkthyer në gjuhën shqipe dhe i noterizuar.”

Në përmbushje të këtij kriteri nga verifikimi i komisionit të ofertave , operatori ekonomik nuk ka ngarkuar në sistem katalog/katalogje të prodhuesit ose fragmente të katalogut/eve të prodhuesit ose skedë teknike të prodhuesit, ku të jetë specifikuar produkti që është paraqitur në ofertë dhe specifikimet teknike, për të gjetur pasqyrim parametrat teknikë të automjetit të ofruar (shasisë dhe agregatit zjarrfikës)

- Referuar Shtojcës 8, “Kriteret e veçanta të kualifikimit ”, “Kapaciteti teknik”, në pikën 2.3.5, ku përcaktohet se:

“ Operatori ekonomik duhet të deklarojë që mjeti është prodhuar në vendet e Bashkimit Europian ose është prodhuar për përdorim në vendet e BE. Për të vërtetuar këtë duhet të paraqesë deklaratën e cila të jetë e shoqëruar me çertifikatën e konformitetit (CoC)/ekuivalent. Ne rastin kur çertifikata e konformitetit (CoC)/ekuivalent është në gjuhë të huaj duhet të jetë i përkthyer në gjuhën shqipe dhe e noterizuar.

Në përmbushje të këtij kriteri nga verifikimi i komisionit të ofertave , operatori ekonomik nuk ka ngarkuar në sistem deklaratën bashkë me çertifikatën e konformitetit (CoC)/ekuivalent që mjeti është prodhuar në vendet e Bashkimit Europian ose është prodhuar për përdorim në vendet e BE.

- Referuar Shtojcës 8, “Kriteret e veçanta të kualifikimit ”, “Kapaciteti teknik”, në pikën 2.3.6, ku përcaktohet se:

“Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë një deklaratë që ka servis të specializuar dhe garanton kryerjen e shërbimeve për riparimin e automjetit objekt i prokurimit, gjatë periudhës së garancisë, në servisin e tij, në një servis të marrë me qira, apo përmes një servisi me të cilin mund të ketë lidhur një kontratë bashkëpunimi të vlefshme përgjatë kohës së realizimit të kontratës, dhe të specifikojë adresën e servisit.”

Në përmbushje të këtij kriteri nga verifikimi i komisionit të ofertave , operatori ekonomik nuk ka ngarkuar në sistem deklaratën që ka servis të specializuar dhe garanton kryerjen e shërbimeve për riparimin e automjetit objekt i prokurimit, gjatë periudhës së garancisë, në servisin e tij, në një servis të marrë me qira, apo përmes një servisi me të cilin mund të ketë lidhur një kontratë bashkëpunimi të vlefshme përgjatë kohës së realizimit të kontratës, dhe të specifikojë adresën e servisit.”

- Referuar Shtojcës 8, “Kriteret e veçanta të kualifikimit”, “Kapaciteti teknik”, në pikën 2.3.7, ku përcaktohet se:

“ Operatori ekonomik duhet të deklarojë nëpërmjet paraqitjes së një deklarate se merr përsipër:

Mbulimin e periudhës së garancisë së automjetit zjarrëfikës pick - up, prej jo më pak se 100,000 km ose jo më pak se 2 vite kalendarike cilado që të arrihet e para për defektet e prodhimit, pjesët mekanike dhe elektrike të automjetit, nga marrja në dorëzim të mallit. Mbulimin e periudhës së garancisë së agregatit zjarrëfikës (pompën, depozitën e ujit, depozitën e shkumës, sistemin e zorrëve, bobinën dhe pajisjet shoqëruese) prej jo më pak se 2 vite kalendarike nga marrja në dorëzim të mallit. Gjatë periudhës së garancisë, operatori ekonomik duhet të sigurojë riparimin ose zëvendësimin e pjesëve me defekt që rezultojnë nga defekte prodhimi ose montimi, pa kosto shtesë për Autoritetin Kontraktor .Automjeti i ofruar (zjarrëfikësja pick -up) është i ri, i papërdorur dhe origjinal. Procesin e targimit, kolaudimit në dorëzim të kryhet nga operatori ekonomik me shpenzimet e këtij të fundit. “

Në përmbushje të këtij kriteri nga verifikimi i komisionit të ofertave , operatori ekonomik nuk ka ngarkuar në sistem deklaratën për mbulimin e garancisë së mjetit dhe agregatit të saj. Gjithashtu nuk ka deklaruar qe automjeti i ofruar (zjarrëfikësja pick -up) të jetë i ri, i papërdorur dhe original si dhe procesin e targimit, kolaudimit në dorëzim të kryhet nga operatori ekonomik me shpenzimet e këtij të fundit .

Për sa më sipër, mbështetur në ligjin nr. 162, datë 23.12.2020 , "Për Prokurimin Publik", i ndryshuar, neni 92, pika 3, ku shprehimisht përcaktohet se: “Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit ”, oferta e operatorit ekonomik "ARTEO 2018"shpk, me NUIS L82523203F s’kualifikohet.

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë Nova Motor Solutions SHPK, me numër NUIS M51901012F, adresa: Tirane Tirane Vaqarr, Magazine 1 kateshe, mbas kështjellës, Konti, Zona Kadastrale 3712, Numer pasurie 18/54, se oferta e paraqitur me vlerë totale prej 4 829 000 (katër milion e tetëqind e njëzet e nëntë mijë) lekë pa TVSH / totali i pikëve të marra [_____] është identifikuar si ofertues i sukseshëm.

Me publikimin e këtij njoftimi, fillojnë afatet e ankimit sipas përcaktimeve në nenin 110 të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar.

TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR
ZYRTARI I AUTORIZUAR

Zv.Kryetari

Eraldi Qirio